



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
DREJTORIA EKONOMIKE

DATE 15/05/2019

RELACION

“MONITORIMI I BUXHETIT PËR PERIUdhËN

JANAR – DHJETOR 2018 “

Realizimi i buxhetit te vitit 2018 eshte bere duke respektuar nenin 64 te ligjit 139/2015 “ *Per veteqeverisjen vendore* “, ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 “ *Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise*” i ndryshuar , 68/2017 date 27.4.2017 “ *Per financat e veteqeverisjes vendore* “, ligjin nr. 10296 date 8.7.2010 “*Per menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar, udhezimin nr. 22 date 30.07.2018 “*Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit te njesive te qeverisjes vendore*” ,udhezimin nr. 9 date 20.03.2018 “*Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit*” ,udhezimi plotesues i Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr.2 dt 19.01.2018 “*Per zbatimin e buxhetit te vitit 2018*” ; ligji 109/2017 dt 30.11.2017 “*Per buxhetin e vitit 2018*” dhe VKB nr.68 dt 20.12.2018 “*Për miratimin e buxhetit të vitit 2019 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2020-20201 të Bashkisë Shijak*” Programi Buxhetor Afatmesëm parashikon një mbulim sa më të plotë të territorit me shërbime publike cilësore me qellim përmirësimin e jetesës së qytetarëve; përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale, përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta; përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit; mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit; nxitjen e investimeve në kërkim ; mbrojtjen e tokave bujqësore, reabilitimin dhe investimin e infrastrukturën bujqësore, promovimin dhe marketingun e produkteve bujqësore; mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij; zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive; sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Shijak; Zbatimi i Programit Buxhetor Afatmesëm është një instrument i rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së jetës, përmirësimin e aksesit, integrimin territorial dhe barazinë në shërbime, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rritjen e cilësisë së jetesës, dhe mbrojtjen e mjedisit duke e kthyer Shijakun në një qendër të përparuar social – ekonomike. Ky dokument ka përcaktuar 13 programe dhe një seri funksionesh dhe aktiviteteve respektive për çdo funksion, prandaj është treguesi më i mirë se si shpenzimet e planifikuara lidhen me veprimtaritë dhe projektet e planifikuara si dhe me Strategjinë e Zhvillimit dhe Planet Vendore që i mbështesin këto projekte.

TE ARDHURAT LOKALE TE BASHKISE SHIJAK

PER VITIN 2018

Në tabelën e mëposhtëme pasqyrohet realizimi i të ardhurave për çdo zë më vete për Bashkinë Shijak :

NR	EMËRTIMI	VITI 2018			
		Plan 12 Mujor	Fakti 12 Mujor	Realizimi ne %	Diferenca ne Lek
A.	TË ARDHURA TATIMORE	160,699	111,704	69.5	(48,995)
I	Taksambipasurine e Paluajtshme	72,473	51,723	71.4	(20,751)
a.	Taksambindertesën	44,637	40,841	91.5	(3,796)
	Biznesi	38,573	37,456	97.1	(1,117)
	Popullsia	6,064	3,385	55.8	(2,679)
b.	Taksa mbi Token Bujqesore	21,836	8,724	40.0	(13,112)
II	TaksaVendore Biznesi I Vogel	6,000	2,157	36.0	(3,842)
III	Teardhuratetjervendore	74,082	45,241	61.1	(28,841)
b.	Taksa e Ndikimit ne Infrastrukture per Ndertesat e reja	69,000	41,285	59.8	(27,714)
c.	Taksa e Truallit	5,082	3,955	77.8	(1,126)
IV	Taksateadministruarangaagjentetatimore	11,146	11,066	99.3	(79)
a.	Taksa per Kalimin e Pasurise se Paluajtshme	1,346	515	38.3	(831)
b.	Taksa e mjetevetepedoruara	9,800	10,551	107.7	752
V	Taksa e Tabeles	2,997	3,672	122.5	676
a.	per qellimeIdentifikimi	150	254	169.7	105
b.	per qellimeReklamimi	2,847	3,418	120.1	571
B.	TE ARDHURA JOTATIMORE				-
I	Teardhuratngatarifat	35,953	30,360	84.4	(5,593)

1	Tarife e Pastrimitdhe e Gjelberimit	27,568	14,554	52.8	(13,013)
	Biznesi	14,062	10,530	74.9	(3,532)
	Popullsia	13,506	4,024	29.8	(9,481)
2	Tarife e Ndricimit	2,225	1,144	51.4	(1,081)
	Biznesi	1,040	741	71.3	(298)
	Popullsia	1,185	402	34.0	(782)
3	Tarifa per SherbimeVeterinare	150	11	7.9	(138)
4	Tarifa e Sherbimittetransportit	3,000	2,894	96.5	(106)
5	TarifaeParkimit	50	39	78.0	(11)
6	Tarifapervertetime,autorizimeetj	100	639	639.6	539
7	Tarifatesektorittebujqesise e pyjeve	900	760	84.5	(140)
8	Tarife sherbimi nga institucione arsim kulture sport	200	276	138.0	76
9	Tarife per sherbime MKZ	200	857	428.5	657
10	Tarifa e tregutte lire	530	532	100.5	2
11	Tarife per zenie hapsire publike	30		-	(30)
12	Tarifa e drejtorise konrtollit dhe zhvillteritorit	1,000	8,650	865.0	7,650
C.	TE ARDHURA TE TJERA	7,300	2,470	33.8	(4,831)
I	Te ardhura nga institucionet	1,800	1,316	73.1	(485)
a.	TeArdhura Kopeshte Cerdhe	1,800	1,316	73.1	(485)
II	Te ardhura te tjera	5,500	1,154	21.0	(4,346)
1	Detyrime te pambledhura 2017	4,970		-	(4,970)
2	Gjoba nga mos shlyerja ne afat e detyrimeve	30	587	1,957.1	557
3	Gjoba per shkeljet administrative	500	567	113.4	67
	TOTALI	203,953	144,536	70.9	(59,426)

Sic shihet nga tabela Realizimi i të Ardhurave në Total (Janar – Dhjetor) i të Ardhurave në total është në masën 70.9%. dhe ne vlere – 59.426 mije leke

E shprehur nëpërqindje totali i realizimit të të ardhurave nga taksa e ndertesës (Biznes + Popullsi) është në masën 91.5 % dhe ne vlere - 3.796 leke. Ose 6.3 % te totalit te mosrealizimit.


1. Taksa mbi Ndërtesën : Panifikimi i taksës së ndërtesës; ku ndahej në dy pjesë :

Plan 12 – Mujor 2018: Taksë mbi Ndërtesën (Biznes) 38.573 leke

Taksë mbi Ndërtesën (Popullsi) 6.064 leke

Fakt 12– Mujor 2018: Taksë mbi Ndërtesën (Biznes) 37.456 leke

Taksë mbi Ndërtesën (Popullsi) 3.385 leke



Sektori I taksave po punon për përmirsimin e bazës së të dhënave mbi ndërtesat mbështetur në metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “Ndërtesa”. Sektori I taksave bën çdo mua jrakordimin e të ardhurave nga taksa e ndërtesës me 3 - njësitë administrative.

2. Taksa mbi Tokën Buqësore :


Plan 12 – Mujor 2018: 21.836 leke **Fakt 12– Mujor 2018:** 8.724 leke

Realizimi i të ardhurave nga kjo taksë është në masën 40%.Taksa mblidhet nga inspektorët e taksave pranë njësive administrative Xhafzotaj ,Maminas,Gjepale. Ka vështirësi në mbledhjen e taksës së tokës buqësore për shkak të aftësisë së pakët paguese që kanë banorët e fshatrave të njësive administrative.Sektori I taksave bën cdo muaj rakordimin e të ardhurave nga taksa e tokës buqësore me njësitë administrative .Kjo takes krijon nje deficit prej 13.112 mije lekesh ose 22 % te mosrealizimit gjithsej.

3.Taksa Vendore Biznesi i Vogel :

Realizimi i të ardhurave nga ky zë shkon në masën 36 %.ose ne vlere -3 842 leke ky ze zen 6.4 % te totalit te mosrealizimit

Plan 12 – Mujor 2018: 6.000 leke **Fakt 12 – Mujor 2018:** 2.158 leke



Agjenti tatimor për mbledhjen e taksës vendore të biznesit tëvogel është Drejtoria e Tatim Taksave Durrës.Sektori i taksave bën cdo muaj rakordimin me këtë drejtori lidhur me të ardhurat e gjeneruara nga kjo taksë.

4.Tarifë Aluizni & Taksa e ndikimit në Infrastrukturë :

Realizimi i të ardhurave nga taksa e Infrastrukturës shkon në masën 60%.ose – 27.714 qe perben 46 % te totalit te mosrealizimit

Plan 12 – Mujor 2018: 69.000 leke **Fakt 12 – Mujor 2018:** 41.286 leke

Taksa e Ndikimit ne Infrastruktura per Ndertesat e reja



Taksa e ndikimit në infrastrukturë mbledhet nga Drejtoria e Urbanistikës në momentin e aplikimit për leje. Planifikimi i të ardhurave nga kjo taksë është bërë duke marrë parasysh realizimin e të ardhurave nga taksa të vitit paraardhës.

5. Taksa e truallit :

Të ardhurat e taksës së truallit shkon në masën 78 %.

Plan 12 – Mujor 2018: 5.082 leke **Fakt 12– Mujor 2018:** 3.956 leke

Të dhenat për trojet janë në permiresim të përditshëm pasi kjo takse u fut për herë të parë në vitin 2017 me ligj ,pasi nuk kemi të dhëna nga ZRPP Durrës megjithë kërkesat tona drejtuar këtij institucioni ,kështu edhe planifikimi është bërë në mënyrë të përafërt.

6. Taksa e Regjistrimi të Përvitshëm të Mjeteve te Përdorura :

Realizimi i kësaj të ardhure është 108 %.

Plan 12 – Mujor 2018: 9.800 leke **Fakt 12 – Mujor 2018:** 10.552 leke ose + 752 mije leke

Agjenti tatimor për mbledhjen e taksës së mjeteve të përdorura është DSHA Durres. Sektori i taksave bën rakordime periodike me këtë drejtori për sa i përket të ardhurave të mbledhura nga kjo taksë.

7. Taksa e tabelës : Të ardhurat nga kjo taksë paraqiten si më poshtë:

Realizimi i të ardhurave nga taksa e tabelës për qëllime identifikimi shkon nëmasën 123%. Tabela për qëllime reklamimi dhe identifikimi:

Plan 12 – Mujor 2018: 2.997 leke **Fakt 12 – Mujor 2018:** 3.673 leke ose +676 mije leke

8. Tarifa e Pastrimit dhe e Gjelbërimit : Planifikimi i tarifës së pastrimit dhe gjelbërimit ka qenë në total 14.555 lek; ku ndahej në dy pjesë :


E shprehur në përqindje totali realizimit i tarifës së pastrimit dhe gjelbërimit (Biznes + Popullsi) është në masën 52.8 %, ku 74.9 % e përbën Biznesi dhe 29.8% Popullsia. Sic shihet nga të dhënat e mësipërme në nivel më të ulët mosrealizimi i kësaj tarife vjen nga popullsia, kjo si rezultat i faktorëve social dhe ekonomike. Nga ana e sektorit të taksave janë dërguar njoftime detyrimit për çdo familje . Në përmirësimin e mbledhjes së të ardhurave nga tarifa e pastrimit dhe ndricimit do të ndikojë futja e detyrimeve në faturen e ujit ,në momentin e kalimit të ujës në kanalizime në administrimin e bashkisë. Paraqitja grafike si më poshtë:

Plan 12 – Mujor 2018: Tarifë mbi Pastrimin (Biznes) 14.062

Tarifë mbi Pastrimin (Popullsi) 13.506

Fakt 12 – Mujor 2018: Tarifë mbi Pastrimin (Biznes) 10.530

Tarifë mbi Pastrimin (Popullsi) 4.025



9. Tarifa e Ndrimit: Panifikimi i tarifës së ndricimit ka qenë në total 1.144 lekeku ndahej në dy pjesë :

E shprehur në përqindje në total realizimi i të ardhurave nga Tarifa e Ndrimit (Biznes + Popullsi) është në masën 51.4%, ose -1.081 mije leke në vlerë, ku 71.3% e përbën Biznesi dhe 34% Popullsia.

Plan 12 – Mujor 2018: Tarifë e Ndrimit (Biznes) 1.040 leke

Tarifë e Ndrimit (Popullsi) 1.185 leke

Fakt 12 – Mujor 2018: Tarifë e Ndrimit (Biznes) 742 leke

Tarifë e Ndrimit (Popullsi) 403 leke

10. Tarifa e Drejtorisë së Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit :

Realizimi i të ardhurave nga Tarifat e Drejtorisë së Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit shkon në masën 865 %. Këto tarifa paguhen në momentin e marrjes së lejeve të ndryshme nga Sektori i Urbanistikës. Planifikimi i këtyre tarifave bëhet duke marrë parasysh realizimin e vitit paraardhës dhe aplikimet për leje të ndryshme.

Plan 12 – Mujor 2018: 1.000 leke **Fakt 12 – Mujor 2018:** 8.650 leke

12. Tarifa për Dhënie Leje Transporti:

Plan 12 – Mujor 2018: 3.000 leke **Fakt 12 – Mujor 2018:** 2.894 leke

Realizimi i të ardhurave nga tarifa e lejeve të transportit shkon në masën 97 %.

Tarifa për dhënien e lejeve të transportit lëshohet nga Sektori I Shërbimeve. Planifikimi i këtyre tarifave bëhet duke marrë parasysh realizimin e vitit paraardhës dhe aplikimet për leje të ndryshme.

15. Të ardhurat nga Kopeshti + Cerdhja :

Realizimi i të ardhurave nga tarifat e Kopështit + Cerdhes janë 73 %.

Plan 12 – Mujor 2018: 1.800 leke **Fakt 12 – Mujor 2018:** 1.317 leke

16. Tarifë për Shërbime MZSH :

Realizimi i të ardhurave nga Tarifat për Shërbimin e MZSH janë në masën 428.5%. Këto tarifa administrohen nga Sektori i MZSH:

Plan 12 – Mujor 2018: 200 leke **Fakt 12 – Mujor 2018:** 857 leke

Në territorin e Bashkisë Shijak për vitin 2018 ushtruan aktivitet 832 subjektenga të cilat 220 subjekte Biznes i Madh dhe 611 subjekte biznes i vogël.

Kanë shlyer detyrimet 576 subjekte nga të cilat 152 biznesi i madh dhe 424 biznesi i vogël.

Të ndarë sipas njësisive administrative nr. i bizneseve paraqitet në tabelën e mëposhtëme:

		Nj.A.Shij	Nj.A.Xhafz	Nj.A.Mamin	Nj.A.Gjep	Gjithsej
1	Biznesi i Madh	36	146	35	3	220
	Paguar	29	99	24	0	152
	Papaguar	7	47	11	3	68
2	Biznesi i vogel	215	279	93	26	613
	Paguar	168	182	63	11	424
	Papaguar	47	97	30	15	189

Gjatë periudhës Janar –dhjetor 2018 kanë pezulluar aktivitetin 67 subjekte nga të cilat 13 subjekte biznesi i madh dhe 54 subjekte biznesi i vogel.

Produktet për vitin 2018

Aktivitetet dhe projektet që u realizuan për v.2018 janë:

Ndërtim i administratës së Bashkisë së Shijak në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të Bashkisë së Shijak për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Kemi synuar sigurimin e mbështetjes së funksionimit të administratës së Bashkisë Shijak përmes realizimit në kohë të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Mbështetje e strukturës funksionale me 174 punonjës.

Plotesim sipas nevojës dhe rekrutimi i personelit të administratës vendore në mënyrë transparente, me profesionalizëm dhe në bazë të meritave, aftësive profesionale, pavarësisë dhe integritetit, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë dhe korrektesës dhe në zbatimin e ligjeve:

Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli u bazua tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Paga, shtesat mbi pagat e punonjësve bëhen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165 datë 02.03.2016 ”Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, VKM nr. 717, date 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” të ndryshuar; Numri i aplikuesve për vendet e shpallura ishte rreth 16 aplikues.

Këto rekrutime janë realizuar me procedurën e 1 lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë 3 për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese dhe pranimit në 12 shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Kjo procedurë është realizuar përmes konkursit të hapur në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar,

VKM Nr. 242, datë 18/03/2015, VKM Nr. 243, datë 18/03/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”. Konkurimi ka ndjekur disa etapa, përfshirë ngritjen e Komisioneve të pranimit. Anëtarë të komisioneve të vlerësimit gjatë procesit të rekrutimit kanë qenë punonjës të nivelit drejtues të administratës publike vendore si dhe ekspertë jashtë institucionit të Bashkisë Shijak. Realizuar 16 procedura ne kategorine ekzekutive me nga dy eksperte te jashtem

Trajnimi i burimeve njerëzore të Bashkisë së Shijak

Ky aktivitet synonte që nëpunësit civilë për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë të mund të kryenin trajnime në institucione të tjera trajnuese me inisiativën e tyre, për detyrën që ata kryejnë, me propozimin e përbashkët të eprorit e të drejtuesit të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit dhe me miratimin e titullarit të institucionit. Gjatë vitit 2018 janë zhvilluar 52 per trajnime për 28 punonjes si: trajnime të vijueshme profesionale të audituesve të brendshëm, trajnim të punonjësve të saporekrutuar për detyrat dhe përgjegjësi e pozicioneve të punës, për realizimin e objektivave të drejtorive përkatëse etj. Këto trajnime janë realizuar me mbështetjen e Bashkisë Shijak dhe të donatorëve, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore përgjegjëse.

Mbështetje dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin e administratës së Bashkisë

Është përmirësuar funksionimi normal i të gjithë administratës së Bashkisë së Shijak nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse bazë si ujë, energji elektrike, ngrohje, komunikim postar, shërbim telefonie etj.

Shërbim me kancelari dhe shtypshkrime për administratën e Bashkisë së është mundësuar sigurimi dhe furnizimi i vazhdueshëm me kancelari, letër, bojë, shtypshkrime etj përt'iu mundësuar punonjësve përmbushjen e detyrave administrative për të gjithë administratën.

Shërbime mbështetëse bazë të mirëmbajtjes (materiale elektrike, dhe paisje të tjera shtesë) Gjatë vitit 2018 janë realizuar blerja e materialeve, elektrike dhe bojera, stuko etj për lyerje.

Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e administratës së Bashkisë së Shijak . Është realizuar furnizimi sistematik me karburant i mjeteve të transportit për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të administratës vendore të Bashkisë nevojave në qendër , njësi administrative etj . U realizua shërbimi i riparimit për të gjitha automjetet,shlyerja e të gjitha sigurimeve, taksave të qarkullimit dhe kolaudimit vjetor të mjeteve të transportit në shërbim të administratës .

Blerje pajisje zyre për administratën e Bashkisë së Shijak

Është realizuar blerja e paisjeve të reja si tavolina,karrike ,etazherë, grrila dhe kondicionerë në shërbim të administratës vendore.

Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake

Është realizuar pajisja me uniforma për Policinë Bashkiake për vitin 2018, bazuar në ligjin 8224 ,date 15.05.1997 ”Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës, i ndryshuar dhe VKM nr. 333 datë 02.06.1998 për “Miratimin e normës së veshmbathjes për policinë”, i ndryshuar, dhe urdherat në zbatim të këtij ligji ku përcaktohen qartë standartet dhe kriteret për normat e uniformave të policisë bashkiake. Gjithashtu ne mbeshtetje per kryerjen e funksionit te policise u eshte siguruar furnizimi me karburant dhe mirembajtje per mjetin e tyre.

Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)

Janë siguruar pajisje TIK të reja në shërbim të administratës vendore në Bashkinë Qendër dhe Njësitë Administrative. Gjithsej kompjutera 10(copë), paisje Multifunkisonale 10(copë), tablet monitorues 1 (copë), Kamera 1(copë), Anëtarësimi në Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë Realizuar pagesa e kuotes seanetaresise ne shoqaten e Bashkive te Shqiperise konform marreveshjes se lidhur .

Dita ndërkombëtare e fëmijëve, 1 Qeshori

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve është realizuar aktiviteti në bashkëpunim me Qendrën Kulturore të Fëmijëve, shkollat 9 vjecare dhe organizatat partnere të shoqërisë civile ka organizuar aktivitetin social, kulturor, sensibilizues me pjesëmarrjen aktive të fëmijëve. Ky aktivitet u organizua në Pallatin e cultures “Qazim Domi “pjesëmarrës rreth 200 fëmijë.

Administrimi dhe funksionimi i Çerdheve.

Është realizuar vlerësimi i nevojave për ndërhyrje me qëllim krijimin e kushteve sa më të favorshme për foshnjat që frekuentojnë çerdhe duke sistemuar femijet e kesaj kategorie ne nje ndertese te re te ndertuar nga donator. Numri i femijeve që frekuentojnë këte çerdhe është 28, ndersa numri I femijeve qe frekuentojne kopeshtin me dreke eshte 70.

Gjate 2018 Këshilli Artistiko Kulturor i Bashkise Shijak i përbëre prej 3 anëtarësh funksionoi rregullisht. Ai mori në shqyrtim në bazë të një procedurë të parashikuar në ligj, të gjithë projektet

kulturore, artistike, rinore dhe sportive të Bashkisë Shijak te reflektuar ne 8 mbledhjet e tij vjetore

Pjesë e programit për rininë dhe sportet do të jenë organizimi i përvitshëm i aktiviteteve sportive dhe zhvillimi i sportit në komunitet. Nepermjet programit për rininë dhe sportin mbështeten administrimi dhe funksionimi i Klubit shumësportësh “Erzeni” dhe Klubi i futbollit “Erzeni”. K.Volejbollit “ Erzeni “ eshte shpallur Kampion i Shqiperise per vitin 2018, ndërsa Klubi I Futbollit Erzeni ka patur nje ecuri te mire ne kampionat dhe nje ndjekje te vazhdushme nga tifozet reflektuar , te cilet e kane mbeshtetur fuqimisht skuadrat e qytetit.

Emergjencat Civile kane qene ne gadishmeri te plote gjithe vitin, per te perballuar dhe parandaluar ngjarjet qe mund te ndodhnin. Kane patur suport te vazhdueshem ne mjete, burime njerezore dhe karburant.

Shërbim i MZSH ka patur prioritet parandalimin e ngjarjeve. Është rritur numri dhe llojet e shërbimeve të sektorit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, por struktura e ofrimit të shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi duhet te jete ne perputhje me standartet e kerkuara me ligj. Pervec mjeteve ne posedim kete vit eshte blere autobot në funksion të shërbimit zjarrfikës.

Programi i menaxhimit te territorit mbulon gjithë territorin administrativ të bashkisë me te gjitha llojet dhe karakteret e territorit si ajo urban, rural, bujqësor, natyror apo sipërfaqe ujore.

Gjatë vitit 2018 janë realizuar projekte te ndryshme te rikostruksioneve te rrugeve urbane dhe rurale

- Rikonstruksion Rrjeti Rrugor Qyteti Shijak me fonde te FSHZH
- Rikualifikim i Kuartalles me fondet e bashkise
- Sistemim dhe Asfaltim I Rruges tek Ujesjellesi
- Rehabilitim I Hapesirave Publike Rruga Kokomaneve
- Ndertim I linjes Ujesjellesit Shahinaj Likesh
- Riparim I rrjetit Ujesjelles Gjepalaj
- Ndricimi I Fshatit Pjeze Nj.adm Xhafzotaj

Gjithashtu per nje shërbim sa me te mire te qytetareve te Bashkise Shijak nepermjet mirembajtjes dhe krijimit te infrastructures ne KUZ si me poshte:

- Kanalizim I ujerave te zeza Rr Muhamed Ndraxhi.

Jane shtuar shpenzimet per Energjine Elektrike pasi jane shtuar zonat e ndricuara. Njëkohesisht cilesia e shërbimit te pastrimit eshte ne nivele te mira edhe pse jane shtuar siperfaqet.

Realizuar blerja e nje koshi elektrik per shërbimin e mirembajtjes se ndricimit te rrugeve.

Gjithashtu shërbimet jetike për komunitetin siç janë: a) mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane, b) mirëmbajtja dhe administrimi i sipërfaqeve të gjelberta, c) mirëmbajtja e varrezave publike d) furnizimin me ujë të pijshëm, e) mbledhja, largimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura, f) mbledhja dhe largimi i ujërave të shiut dhe mbrojtja nga përmbytjet në zonat e banuara, g) shërbimi i dekorit publik dhe ndriçimi i mjediseve publike, i) mirëmbajtja e rrugëve urbane dhe rurale si dhe realizimi sipas standarteve të sinjalistikës rrugore po realizohen ne nivel e te kenaqshme. Njëkohesisht cilesia e shërbimit te pastrimit eshte ne nivele te mira edhe pse jane shtuar siperfaqet.

Bujqësia është një nga sektorët më të rëndësishëm ekonomik të Bashkisë, duke qene zone rurale. Jane kryer investime ne bujqesi si Rikostruksione Kanali apo Rehabilitim te Sistemeve Ujitese.

Ndersa per Komunitetin Rom I cili ishte akomoduar ne nje ndertese te vjeter, u jane siguruar ambjente me qera, te cilat paguhen nga Bashkia Shijak. Pjesa tjeter e cila trajtohet me ndihme ekonomike apo pagesa paaftesie eshte sherbyer ne maksimumin e mundshem, duke krijuar hapësira per te qene ndihme e nje numri sa me te madh te tyre.

Gjate 2018 eshte synuar menaxhim me efikasitet i fondeve për arsimin dhe krijimi i mundësive për zhvillim të institucioneve arsimore në të gjithë territorin e Bashkisë Shijak. Ka nisur ndertim I nje shkolle te re 9 vjecare “Rindertimi I Shkolles 9 vjecare Muharrem Dollaku “ne qytet brenda standarteve bashkohore. Gjate gjithë vitit eshte ofruar sherbim mirembajtjeje per shkollat e te gjithë bashkise. Krahas kesaj eshte zhvilluar aktivitetet I rregullt ne qendren komunitare.

ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit				Kodi i Grupit				
Programet		Shpenzimet e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore						
Titulli	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2017	(2) PBA Viti 2018	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2018	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2018	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv	(6) Fakti i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
011	Organet ekzek dhe legjisl, Ceshtjet financaire	125,790	86,547	87,345	48,349	135,694	90,301	(45,393)
013	Sherbime te pergjithsheme	5,969	16,150	8,080	710	8,790	7,492	(1,298)
031	Sherbime e Policise	6,900	7,010	7,551	5,000	12,551	12,466	(85)
032	Sherbimet e mbrojtjes nga zjarri	5,816	12,393	16,022	4,708	20,730	16,022	(4,708)
041	Ceshtjet e pergjith ekonomike, treg punes	5,100	7,912	5,308		5,308	4,943	(365)
042	Bujqesia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia	41,750	30,782	27,877	23,331	51,208	38,175	(13,033)
045	Trasporti ndertim dhe mirembajtje rruges	62,777	252,445	259,949	83,715	343,664	128,592	(215,072)
051	Menaxhimi I mbetjeve	30,000	29,167	31,973	10,000	41,973	28,297	(13,676)
062	Sherbimet publike	53,640	3,231	22,900		86,370	75,299	(11,071)

063	Furnizimi me uje	563	4,956	17,714	2,977	20,691	13,684	(7,007)
081	Sherbimet Rekreative dhe sportive	23,786	34,593	31,856	1,670	33,526	30,619	(2,907)
082	Sherbime kulturre	1,728	6,035	4,745	650	5,395	2,657	(2,738)
091	Arsimi baze dhe parashkollor	60,837	52,342	65,536	35,354	100,890	91,742	(9,148)
092	Arsimi I mesem	2,276	17,486	2,923		2,923	2,909	(14)
104	Familja dhe femijet	3,817	9,150	7,634		7,634	6,524	(1,110)
107	Ndihma ekonomike	170,317	181,946	184,203		184,203	172,540	(11,663)
	Totali	601,066	781,616	781,616	216,464	1,061,550	722,262	(326,515)

Sic shihet nga aneksi nr 1 diferenca 326.515 mije leke tregon shumen e shpenzimeve te perealizuara per vitin 2018 dhe e shprehur ne % eshte 68 % dhe peshen me te madhe e zene program 045 Ndertim dhe mirembajtje rruges per Shumen 215.072 mije lekesh dhe kjo tregon Shumen e investimeve te planifikuara nga FSHZH dhe te pacelura plotesisht. Rik. Sis. Asf rruga Auto Eminas I Vogel /NjA Gjepalaj Rehabilitimi Hapes Rrethrotullimi i 4 Rrugeve Shijak/ NjA Shijak.

ANEKSI nr.3 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"
Projektet me financim te brendshem (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Plani i buxhetit viti 2018	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri ne periudhen aktuale	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri ne periudhen aktuale ne %
0.1110.5	Pershtatje eAmbjenteve te Nj.Ad Xhafzotaj Salle Keshilli Bashkiak	3,500	2,331	67
0.1110.5	Rikon dhe pershtatje e zyrove Gjepalaj	1,451	1,451	100
0.1110.5	Auditim i Aseteve Sha Ujesjelles-Kanalizime	3,590	3,590	100
0.1110.5	Blerje paisje elektronike	1,438	1,438	100
0.1110.5	FV kamerat e sigurise inst ne varesi te Bashkise Shijak	935	688	74
0.1110.5	Blerje pajisje per magazinën dhe guzhina gatimi	200	200	100
0.1110.5	Blerje pajisje multifunksionale	8	8	100
0.1110.5	Blerje kondicioner	643	643	100

0.1110.5	Ndertim i Kabines Elektrike Maminas/ dif fature	230	230	100
0.1110.5	Blerje fuoristrade Dif Fature	200	200	100
0.1110.5	Shpronosim I Varrezave Sallmone	850	850	100
0.1110.5	Blerje Automjeti Koshi Elektrik	2,676	2,676	100
		15,721	14,305	
0.3280.5	Blerje mjete per sektorin e M.Z.SH	3,984	3,984	100
0.4520.5	Sistemim dhe asfaltim I Rruges tek Ujesjellesi	1,477	1,433	97
0.4520.5	Rehabilitim I Rrugeve te Nj.adm Bashkia shijak	2,189	2,189	100
0.4520.5	Rikualifikim i Kuartalles	52,000	51,730	99
0.4520.5	Blerje Cakull dhe Zhavorri ne territorin e Bashkise Shijak	562	562	100
0.4520.5	Kanalizim IUjerave te Zeza Rr M Ndraxhi	2,862	2,862	100
		59,090	58,776	
0.6330.5	Ndertim I linjes ujesjellesit Shahinaj Likesh	1,993	1,993	100
0.6330.5	Riparim I rrjetit Ujesjelles Gjepalaj	1,080	450	42
		3,073	2,443	
0.6440.5	Ndricimi I Fshatit PJEZE Nj.adm Xhafzotaj	4,363	2,222	51
0.8130.5	Shtirim Beton hapës Stadiumi Tofik Jashari	1,670	1,670	100
0.8220.5	Ndertim Lapidari	650	648	100
0.9120.5	Mirembajtje Lyerje shkolla	4,076	4,076	100
0.4520.1	Rikualifikim I Lugines/ Diference fature	109	109	100
0.4520.1	Rehabilitim I Hapesirave Publike Rruga Kokomaneve	55,086	51,371	93
0.4520.1	Rikonstruksion Rrjeti Rrugor Qyteti Shijak	63,362	63,362	100
		118,557	114,842	
0.4220.1	Rikostr I kanalit sekond nga Rezerv Metallaj Koxhas Fushe	7,125	6,944	97
0.4220.1	Rehabilitim Sistemi Ujites Nj.dm.Maminas	11,119	9,511	86
		18,244	16,455	
0.9120.1	Rindertim i shkolles 9-Vjecare "Muharrem Dollaku"	28,464	28,031	100
		257,892	247,452	96

Projektet me financim te huaj (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Buxheti	Plani i buxhetit viti	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	Komente
		Kontraktuar			
	Fushe Sportive ne Shkollen 9 Vjecare Rilindja Sallmone,Nj.Ad Xhafzotaj.	5736698	5736698	4497398	78%

Ky Investim eshte realizuar me mbeshtetjen e Qeverise Zviceriane nepermjet e Projektit “Programi i Zhvillimit Rajonal për Shqipërinë”ky projekt perfundon ne 15 Mars 2019 per vleren e plote 5.975mije leke duke bere te mundur shtimin e ambienteve sportive ne njesite e Bashkise Shijak.

Programi 011 Organet ekzekutive dhe legjislative,Ceshtjet financiare eshte realizuar ne masen 67 % ose - 45.393 mije leke dhe ketu vetem mosrealizimi I Inevstimeve ne kete program ze 62 % te ketij program ose 27.559 mije leke,moslikujdimi I ketyre shpenzimeve ka ardhur nga vendosja e limitit te cash-it nga qeveria qendrore dhe nga mos realizimi I te ardhurave locale.

Programi 042 Bujqesia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia eshte realizuar 74.5 % ose ne vlere - 13.033 mije leke,ketu kemi 2076 mije leke teprica nga fondet e Kanaleve Ujitese dhe Kulluese, dhe diferenca nga limiti I cash-it.

Programi 051 Menaxhimi I mbetjeve eshte realizuar 68 % ose -13.677 mije leke kjo eshte nga moslikujdimi I faturave te pastrimit nga vendosja e limitit te mesiperm.

Programi 062 Sherbimet publike ,realizuar ne masen 50 % kjo nga mos realizimi I te ardhurave .

Programi 063 Furnizimi me Uje realizuar ne masen 70 % ose - 5.783 ketu kemi investimet te pa realizuar ne masen e planifikuar ne kete program u realizua vetem furnizim vendosje e materialeve per Ujesjellesin ne fshatrat Eminas,Shtraze

Programi 081 Sherbimet Rekreative dhe sportive realizuar ne masen 91 % ose -2.907 mije leke jane honorare e sportit te padhena per vendosjen e limitit.

Programi 091 Arsimi baze dhe parashkollor eshte realizuar 86 % , ne kete program jane realizuar shpenzimet baze me te domosdoshme , si energji, uje, dru zjarri gaz per ngrohje te mirembajtje te ndryshme ,diferenca prej 8.714 mije lekesh ka ardhur nga mungesa e te ardhurave .

Auditimi I veprimtarise financiare te Bashkise Shijak

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Shijak, në bazë të programit të auditimit nr. 1003/1 prot, datë 07.09.2018 të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, për periudhën nga data 01.01.2016 deri më datën 30.09.2018, u konstatuan disa mangësi dhe shkelje të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, të cilat më hollësisht janë trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bashkëlidhur kësaj shkrese.

Bazuar në nenet 6, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe **Vendimin nr. 239, datë 21.12.2018 të Kryetarit të KLSH**, për përmirësimin e gjendjes, ju rekomandojmë zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi.

Buxheti i Bashkisë Shijak, *për vitin 2016* është miratuar me VKB-në nr. 6, datë 2.02.2016, *duke qenë në shkelje të afateve ligjore*, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.6.2006 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 32, ligjit nr. 68-2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 33 dhe UMF nr. 8, datë 29.3.2012 “Procedurat e përgatitjes së buxhetit afatmesëm”, kap. V, pika 92.

-Nuk janë miratuar nga Këshilli i Bashkisë, treguesit faktik të realizimit të buxhetit në periudha 6-mujore, 9-mujore dhe në fund të vitit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.6.2006 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” i ndryshuar, neni 47.

-Në një rast të investimeve nga grandet e kushtëzuara për vlerë të fondit limit 38,517,497 lekë, objekti: “Ndërtimi i Shkollës 9-vjeçare fshati Shtrazë” nuk është paraqitur në Këshillin e Bashkisë për miratim të objekteve, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat e përgatitjes së buxhetit afatmesëm” kap. I, pika 5.

-Të gjitha objektet e tenderuar për vitin 2016, nuk janë miratuar më parë me nga Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) si dhe në kuadër të miratimit të Programeve Buxhetore Afatmesëm, në kundërshtim me kërkesat e UMF Plotësues me nr. 1, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”, pika 12-e dhe UMF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standard të përgatitjes, programimit të buxhetit afatmesëm”, Kap. V, pikat 94, 109, 116.

-Për vitin 2018, buxheti i Bashkisë është miratuar me VKB nr.29 datë 20.12.2017.

1.1.Rekomandimi: Bashkia Shijak, të marrë masat e nevojshme, me qëllim që të gjitha investimet e programuara, të realizohen sipas afateve të parashikuara në treguesit e buxhetit.

Menjëherë e vazhdimisht

2.Gjetje nga auditimi.

Llogaria aktive e bilancit 202 “*Studime e projekte*” për vlerën kontabël 14,409,516 lekë, është e analizuar për 3 projekte dhe studimeve të financuara në vite. Nga auditimi u konstatua se administrimi e projekteve dhe studimeve të investuara, nuk është bërë ndonjëherë inventarizimin fizik i tyre në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, neni 7, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve

në njësitë e sektorit publik”, kap. III pikat 26, 35/b, 35/c dhe kap IV, pika 73 dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kap. II, pika 1 (trajtuar më hollësisht në faqet 24-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Të merren masat, të verifikohet saktësia e llogarisë 202 “Studime e projekte” bazuar në inventarizimin mbi gjendjen fizike të studimeve dhe projekteve të financuara në vite në zbatim të kërkesave ligjore.

Menjëherë

3.Gjetje nga auditimi.

Llogaria aktive e bilancit 230 “Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara” për vlerën kontabël 42,419,840 lekë, duhet të sistemohet për të pasqyruar saktë përmbajtjen ekonomike të veprimeve kontabël pasi:

3.1.Rekomandimi: Të merren masat, të sistemohen veprimet kontabël në debi të llogarive; 202 “Studime e projekte” për shumën 40,853,040 lekë dhe 231 “Investime” për shumën 1,566,800 lekë, në kredi të llogarisë 230 “Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara”.

Menjëherë

4.Gjetje nga auditimi.

-Llogaria 211 “Pyje, kullota plantacione” për vlerën kontabël 4,830,000 lekë.

Në zyrën e financës, nuk disponohen të dhëna mbi përmbajtjen e kësaj llogarie si, dokumente kontabël, regjistra etj. dokumente justifikues.

Kjo llogari për vlerën e mësipërme, është e hartuar nga *ish-Komuna Xhafzotaj* sot Njësi Administrative e Bashkisë Shijak, në kuadër të reformës administrative.

4.1.Rekomandimi:REKOMANDOJMË

Të merren masa, të saktësohet përmbajtja e llogarisë 211 për vlerën kontabël 4,830,000 lekë me qëllim justifikimin e veprimeve kontabël në vite me dokumentacionin e nevojshëm teknik ligjo dhe nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse për pasqyrimin e saj pa pasur dokumentacionin e nevojshëm ligjor.

Menjëherë

5.Gjetje nga auditimi.

-Llogari 212 “Ndërtime konstruksione” për vlerën kontabël 559,861,929 lekë, përfaqëson vlerën e objekteve ndërtimore që administrohen nga Bashkia Shijak nga të cilat për periudhën ushtrimore të vitit 2017, janë investuar 16,12,176 lekë.

5.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak, të merren masat për verifikimin e gjendjes fizike të aktiveve

të qëndrueshme të kontabilizuar në llogarinë 212 “Ndërtim konstruksione” me qëllim; përcaktimin e statusit juridik të tyre dhe përgatitjen e dokumentacionit tekniko ligjor të nevojshme për regjistrimin në pronësi të saj.

Brenda muajit Qershor 2019

6.Gjetje nga auditimi.

Në debi të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” është kontabilizuar shuma 82,141,666 lekë e analizuar për shumat:

-28,947,791 lekë, debitorë sipas rekomandimeve të KLSH-së nga auditimet e mëparshme,

-10,585,969 lekë debitorë për tatim taksat lokale të bizneseve dhe

-42,607,906 lekë debitorë për taksat familjare.

6.1.Rekomandimi: Të merren masat që kontabilizimi i kërkesave për arkëtim të debitorëve, të bëhet bazuar në dokumentet ligjorë dhe rregullat kontabël.

Të sistemohet llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” duke saktësuar detyrimet debitorë me zyrën e Tatim Taksave të Bashkisë Shijak e cila ndjek kontabilitetin e detyrimeve për tatim taksat lokale.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi

Nga auditimi i veprimeve kontabël, u konstatua se në të gjitha rastet, nuk janë kontabilizuar si detyrim në kredi të llogarive 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, faturat e pa paguara të prera gjatë vitit 2017, bazuar në situacionet e punimeve të kryera nga të tretët sipas kontratave me sipërmarrje.

Nga auditimi i pagesave me bankën për periudhën e 3-mujorit të parë të vitit 2018, u konstatuan se është paguar në 11 raste shuma 86,627,012 lekë për subjektet sipërmarrëse sipas faturave të lëshuara në vitin 2017.

Kjo shumë, nuk është pasqyruar në kredi të llogarive 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, veprime në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kap. I, pika 1 (trajtuar më hollësisht në faqet 24-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1.Rekomandimi: Zyra e Financës, të bashkëpunojë me Sektorin e zbatimit të kontratave, me qëllim kontabilizimin në kohë të faturave të lëshuara nga të tretët sipas kërkesave të VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”.

Vazhdimisht

8.Gjetje nga auditimi.

Nga auditimi mbi administrimin e aseteve të Bashkisë Shijak, u konstatua shkelje të procedurave për inventarizimin e kryer në fund të vitit 2016 dhe 2017:

8.1.Rekomandimi: Bashkia Shijak, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë përse nuk janë zbatuar plotësisht procedurat ligjore për inventarizimi e aseteve, miratimin për nxjerrjet jashtë përdorimit të tyre, në zbatim të kërkesave ligjore.

Nga Bashkia Shijak, të analizohen shkeljet e konstatuara dhe të merren masat e nevojshme me qëllim që për inventarët e propozuar për nxjerrje jashtë përdorimit, të evidentohen shkaqet e dëmtimit të tyre, personat përgjegjës nëse ka dhe të vlerësohet vlera e mbetur e tyre.

Brenda muajit Janar 2019

9.Gjetje nga auditimi.

Për të vlerësuar funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollit”, grupi i auditimit testoi disa nga komponentët vlerësues të funksionimit të kontrollit të brendshëm;

Mjedisi i kontrollit. Strukturat e Bashkisë, funksionojnë sipas detyrave të përcaktuara në rregulloren e brendshme të miratuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 4686, datë 19.12.2016.

- Numri i përgjithshëm i punonjësve për vitin 2018 është miratuar me VKB “ Për miratimin e buxhetit” me nr. 29 datë 20.12.2017.

-STRUKTURA ORGANIZATIVE E BASHKISË SHIJAK, ËSHTË MIRATUAR ME URDHËR TË BRENDSHËM TË KRYETARIT TË BASHKISË ME NR.117, DATË 11.01.2018, NDRYSHUAR ME URDHËRIN NR. 853, DATË 12.03.2018.

-Nga 192 punonjës gjithsej, 101 punonjës janë vende pune që trajtohen me kontratë sipas ligjit “Për kodin e punës” kurse 72 janë vende pune që trajtohen me Statusin e Nëpunësit Civil, nga të cilët vetëm 67 vend pune e kanë fituar statusin e nëpunësit civil *kurse diferenca për 5 vende pune ose 7%, nuk janë ende me statusin e nëpunësit civil.*

-Në këtë Njësi Qeverisjes Vendore, nuk aplikohen programe elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar.

-*Menaxhimi i riskut.* Me urdhër të Titullari të Bashkisë nr. 4614, datë 15.12.2016, është caktuar koordinatori por nuk na u paraqitën të dhëna lidhur identifikimin dhe menaxhimin e riskut në kundërshtim me kërkesat ligjore.

Veprimtaritë e kontrollit. Nga ana e Titullarit të Bashkisë Shijak, nuk janë nxjerrë urdhra me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit, në kundërshtim me kërkesat e nenit 22 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010.

9.1.Rekomandimi: Të merren masat e nevojshme për implementimin e kërkesave të Ligjit nr.10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollit” i ndryshuar.

Të merren masa për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore duke zbatuar strukturën organizative të miratuar, plotësimin e vendeve që trajtohen me Statusin e Nëpunësit Civil sipas ligjit, me procedurën e konkurrimit.

Të merren masa për identifikimin e aktiviteteve me risk dhe për menaxhimin e tij.

Të analizohen shkaqet e mos funksionimit të aktivitetit të GMS-së, të nxirren përgjegjësitë më qëllim që GMS-ja të kryejë funksionet e veta ligjore në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, ligjit nr. 68-2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe UMF Plotësues nr. 8 datë 29.3.2012 “Procedurat e përgatitjes të Buxhetit afatmesëm”, Kap. V.

Brenda Muajit Dhjetor 2018

10.Gjetje nga auditimi.

Nga dokumentacioni i arkës, është konstatuar një numër i madh veprimesh nëpërmjet arkës me lekë në dorë, veprime në kundërshtim me pikën 63 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (*trajtuar më hollësisht në faqet 24-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1.Rekomandimi: Të mënjanohej veprimet nëpërmjet arkës me lekë në dorë dhe të kryhen vetëm nëpërmjet bankës, konform Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Në vijimësi

11.Gjetje nga auditimi.

Nga administrata tatimore e bashkisë, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk janë plotësuar njoftimet e detyrimit, nuk u janë dërguar në rrugë postare të gjithë subjekteve tatimpagues që kanë detyrimin ligjor për të paguar taksat dhe tarifave vendore si, për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, tarifën e ndriçimit, tarifën e gjelbërimit, taksën e tabelës dhe për taksën mbi ndërtesat dhe për pasojë nuk janë arkëtuar detyrimet ligjore nga subjektet taksapagues, veprimi dhe mosveprimi është në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr.9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 23, pika 2 (*trajtuar më hollësisht në faqet 24-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1.Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Shijak, të marrë masa në fillim të çdo viti buxhetor të plotësojë dhe të dërgojë njoftimet e detyrimeve në rrugë postare të gjithë subjekteve tatimpagues, ku të kërkojë arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi.

- Në fund të vitit 2017 rezultojnë debitorë për taksa dhe tarifa vendore 243 subjekte të biznesit të vogël dhe 42 biznesit të madh, llogaritet mungesë të ardhurash me efekt negativ në vlerën 20,698,084 lekë (*trajtuar më hollësisht në faqet 24-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1.Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Shijak, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar të marrë masat për arkëtimin e detyrimeve tatimore duke bërë njoftim vlerësimet tatimore:

-për 243 subjekte të biznesit të vogël dhe 42 biznesit të madh, llogaritet mungesë të ardhurash me efekt negativ në vlerën 20,698,084 lekë.

Duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a- Tu dërgohen bankave (subjekteve që nuk u është dërguar) urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

b- Të dërgoj në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

c- Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 %, kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

ç- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë, nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative, të bëhet kallëzim penal.

d- Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Shijak, të listojë në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të familjarëve dhe taksën e tokës nga fermerët. Në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, pika 76, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, të njoftohen tatim paguesit familjarë dhe bizneset me Njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale (të Bashkisë) për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të njoftim vlerësimi me anë të zyrës postare për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të pa paguara si; taksën e tokës, banesave dhe tarifave të tjera.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi.

Në 3 raste në zbatimin e kontratës për punë “Rikualifikim i kuartallës Lagja Kodër Shijak” Bashkia Shijak të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkia Shijak dhe nga Bashkimit të Operatorëve

Ekonomik "EURO-ALB" & "Sireta 2F" Shpk përfaqësuar nga shoqëria "EURO-ALB", nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit në objekt u konstatua se, në aksin nr. 5, aksi nr. 5/1 dhe aksi 5/2, për rreth 70 m² të shtresave asfaltme (Binder + asfaltobeton) ka filluar dëmtimi i tyre, shtresat asfaltme janë çarë, gjithashtu, janë dëmtuar disa puseta shiu dhe shtresa e betonit e vendosur në trotuare (*trajtuar më hollësisht në faqet 121-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak t'i kërkohet shoqërisë, Bashkimit të Operatorëve Ekonomik "EURO-ALB" & "Sireta 2F" përfaqësuar nga shoqëria "EURO-ALB" Shpk, të marrë masa për riparimin e defekteve të konstatuara në shtresat asfaltme, në shtresën e betonit në trotuare dhe riparimin e pusetave të shiut, brenda periudhës së garancisë së defekteve si detyrim kontraktual i përcaktuar në kontratën dy paleshe.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi.

Në auditimin e dokumentacionit **mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e fundit**, konstatohet se nga Bashkia Shijak, megjithëse është punuar në drejtim të zbatimit të tyre, akoma situata nuk është vlerësuar sa dhe si duhet, duke mos ndjekur deri në fund procedurat ligjore në zbatimin e rekomandimeve, kryesisht ato që kanë lidhje me shpërblim dëmi, veprime në shkelje të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit*", konkretisht:

KLSH ka rekomanduar 27 masa organizative, të pranuar të gjitha dhe të zbatuara 17 prej tyre ose 63%, janë në proces 10 masa.

Janë rekomanduar 24 masa me karakter shpërblim dëmi, të pranuar të gjitha, dhe të zbatuara plotësisht 16 prej tyre ose 67%, për vlerën prej 1,309,691 lekë, janë zbatuar pjesërisht dhe janë në proces zbatimi 2 masa për vlerën 454,764 lekë duke mbetur për arkëtim vlere prej 826,713 lekë, janë në proces 6 masa ose 25% për vlerën prej 24,393,751 lekë.

Janë rekomanduar 7 masa me karakter Disiplinor, të pranuar të gjitha, por të zbatuara pjesërisht (*trajtuar më hollësisht në faqet 142-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak, të merren masat e nevojshme për të ndjekur me prioritet zbatimin e masave që forcojnë disiplinën financiare dhe risin përgjegjshmërinë e nëpunësve shtetërorë. Për të gjitha detyrimet e mundshme për tu rikërkuar, të vijohet me procedurat administrative dhe ligjore për të siguruar arkëtimin e shpërblimit të dëmit, masave organizative me mungesë të ardhurash, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e përcaktuara dhe rikërkua nga KLSH-ja.

Menjëherë

B.I. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total në vlerën **2,082,910 lekë** pa tvsh në zbatimin e kontratave për punë publike. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën prej 2,082,910 lekë**, si më poshtë:*

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *“Rehabilitimi i hapësirave dhe rikonstruksioni i rrugëve tek lagjja e Kokomanëve, fshati Hardhishtë”, Bashkia Shijak*, me vlerë të kontratës 93,352,259 lekë me tvsh, fituar nga BOE “Senka” dhe “Egland” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 997,990 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 23/24 prot datë 15.08.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Shijak dhe BOE “Senka” dhe “Egland” Shpk (*trajtuar më hollësisht në faqet 121-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Shijak të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **997,990 lekë** pa tvsh nga BOE “Senka” dhe “Egland” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 1308, datë 13.04.2017 me objekt *“Rehabilitimi i hapësirave dhe rikonstruksioni i rrugëve tek lagjja e Kokomanëve, fshati Hardhishtë”, Bashkia Shijak*, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera dhe vonesave në përfundimin e punimeve.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *“Rikualifikimi i sheshit tek lagjja Lugina”, Bashkia Shijak*, me vlerë të kontratës **25,093,368 lekë** me tvsh, fituar nga Operatori Ekonomik “Al-Asfalt” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 324,460 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3411, datë 16.09.2016 të lidhur mes AK Bashkia Shijak dhe OE “Al-Asfalt” SHPK (*trajtuar më hollësisht në faqet 121-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Shijak të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **324,460 lekë** nga Operatori Ekonomik “Al-Asfalt” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. nr. 77/15, datë 22.11.2016 me objekt *“Rikualifikimi i sheshit tek lagjja Lugina”, Bashkia Shijak*, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikualifikim i kuartallës Lagja Kodër Shijak”, *Bashkia Shijak*, me vlerë të kontratës 15,529,200 lekë me tvsh, fituar nga Operatori Ekonomik “Euro-Alb” & “Sireta 2F” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **341,860 lekë** pa tvsh për zërat e punimeve: FV hekur betoni i zakonshëm Ø 6-8 mm; Tuba metalik Ø140 mm; F.V Rërë nën dhe mbi tubacione PE + kompaktësim. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 8, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe kontratën me nr. 2654, datë 25.07.2017(*trajtuar më hollësisht në faqet 121-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandim:Nga Bashkia Shijak të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **341,860 lekë** nga Operatori Ekonomik “Euro-Alb” & “Sireta 2F” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2654, datë 25.07.2017me objekt “Rikualifikim i kuartallës Lagja Kodër Shijak”, *Bashkia Shijak*, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rehabilitimi i Sistemimit Ujitës Njësia Administrative Gjepalaj”, *Bashkia Shijak*, me vlerë të kontratës 56,941,800 lekë me tvsh, fituar nga Operatori Ekonomik “Borava D” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **418,600 lekë** pa tvsh, për zërin e punimeve ndërtim priza 30 x 50 në kanalet vaditës. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 8, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe kontratën me nr. 499, datë 09.02.2017(*trajtuar më hollësisht në faqet 121-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandim:Nga Bashkia Shijak të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **418,600 lekë** nga Operatori Ekonomik “Borava D” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 499, datë 09.02.2017 me objekt “Rehabilitimi i Sistemimit Ujitës Njësia Administrative Gjepalaj”, *Bashkia Shijak*, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

B.II. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE (në vlerën prej 303,664,372 lekë, nga të cilat 296,161,785 lekë pa tvsh në procedurat e prokurimit dhe 7,502,587 lekë në procedurat e zbatimit të investimeve).

B.II.1.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt:“**Rikonstruksion i rrjetit rrugor të qytetit Shijak**”,për vlerën prej 83,325,110 lekë, me BOE të shpallur fitues“**Al-Asfalt**” dhe

“Eurondërtim” Shpk, për vlerën prej **82,806,230** lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 518,880 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 5 OE dhe 1 BOE, nga ku është shpallur fituese BOE e cila nuk plotësonte plotësisht të gjitha kriteret për kualifikim dhe konkretisht në drejtim të stafit teknik, licencave të punëtorëve dhe manovratorëve, si dhe dy mjeteve të cilat nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin përkatës si leje qarkullimi etj.

B.II.2.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Rindërtim i Shkollës 9-vjeçare Muharrem Dollaku, Shijak”**, për vlerën prej **65,888,761** lekë, me BOE të shpallur fitues **“Euro-Alb”** dhe **“Vivante Konstruksion” Shpk**, për vlerën prej **65,486,961** lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 401,799 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 4 OE dhe 4 BOE, nga ku është shpallur fituese BOE e cila nuk plotësonte plotësisht të gjitha kriteret për kualifikim dhe konkretisht në drejtim të stafit teknik dhe paraqitjes së vërtetimit për shlyerjen e detyrimeve të taksave vendore për niptet sekondare.

B.II.3.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Rikualifikim i kuartallës lagjia Kodra Shijak”**, për vlerën prej 47,686,020 lekë, me BOE të shpallur fitues **“Euro Alb”** dhe **“Sireta 2F” Shpk**, për vlerën prej 47,451,500 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 234,520 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 5 OE dhe 1 BOE, nga ku është shpallur fituese BOE e cila nuk plotësonte plotësisht të gjitha kriteret për kualifikim dhe konkretisht në drejtim të tre mjeteve të punës (kamion) të cilat rezultojnë tu ketë kaluar afati i lejes së transportit nga bashkia Kamëz.

B.II.4.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Ndërtim i shkollës 9-vjeçare, fshati Shtrazë Gjepalaj”**, për vlerën prej 38,517,497 lekë, me OE të shpallur fitues **“Regli”** dhe **“Victoria Invest” Shpk**, për vlerën prej **38,454,452** lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 63,045 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 3 OE, nga ku është shpallur fituese OE i cili nuk plotësonte plotësisht të gjitha kriteret për kualifikim dhe konkretisht në drejtim të shlyerjes të detyrimeve vendore për nipte sekondare si dhe tri mjeteve për të cilat nuk ka paraqitur dokumentacionin shoqërues si leje qarkullimi etj.

B.II.5.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Rikualifikim i sheshit të lagjia Lugina”**, për vlerën prej 21,002,162 lekë, me OE të shpallur fitues **“Al-Asfalt” Shpk**, për vlerën prej **20,911,140** lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 91,022 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 3 OE, nga ku është shpallur fituese OE i cili nuk plotësonte plotësisht të gjitha kriteret për kualifikim dhe konkretisht në drejtim të stafit teknik si dhe dy mjeteve për të cilat nuk ka paraqitur dokumentacionin shoqërues si leje qarkullimi etj.

B.II.6.Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Blerje automjete dhe makineri për nevojat e bashkisë”**, për vlerën prej 14,583,333 lekë, me OE të shpallur fitues **“Euro Alb” Shpk**, për vlerën prej 14,580,000 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 3,333 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 3 OE, nga ku është shpallur fituese OE i cili nuk plotësonte plotësisht të gjitha kriteret për kualifikim dhe konkretisht në drejtim të paraqitjes të dokumentit që nuk është dënuar penalisht apo për shkak të aktivitetit profesional, nuk ka të

përcaktuar në ekstraktin e QKR-së tregtimin e mjeteve të kërkuara nga AK, si dhe nuk plotëson kriteret për tre nga mjetet e kërkuara.

B.II.7. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Rikonstruksion i kanalit sekondar nga rezervuari Metallaj-Koxha Fushë”**, për vlerën prej 13,250,528 lekë, me OE të shpallur fitues **“Al-Asfalt” Shpk**, për vlerën prej 13,098,842 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 151,686 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 5 OE, nga ku është shpallur fituese OE i cili nuk plotëson plotësisht të gjitha kriteret për kualifikim dhe konkretisht në drejtim të numrit të punonjësve dhe stafit teknik.

B.II.8. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Rehabilitim i sistemit ujitës njësia administrative Gjepalaj”**, për vlerën prej 13,331,594 lekë, me OE të shpallur fitues **“Borova D” Shpk**, për vlerën prej **12,941,000** lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 390,594 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 7 OE, nga ku është shpallur fituese OE i cili nuk plotëson plotësisht të gjitha kriteret për kualifikim dhe konkretisht në drejtim të stafit dhe tri mjeteve të cilat nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin përkatës si leje qarkullimi etj, duke shkaktuar **përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, efencë dhe efektivitet, në vlerën 12,941,000 lekë**, veprime në pajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 **“Për prokurimin publik”**, i ndryshuar dhe nenet 59 dhe 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**, i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 49-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

B.II.(1-8)1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Shijak, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, për gjetjet e më sipërme, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën totale **296,161,785 lekë pa tvsh** duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda datës 31.03.2019

B.II.9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i situacioneve të likuiduara në objektin **“Rikonstruksioni i rrjetit rrugor të qytetit Shijak”**, rezulton se brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, janë paguar tre situacione me vlerë progresive 41,133,720 lekë dhe nën objekti **“Rikonstruksion i rrugës 16 Shtatori dhe degëzimet”**, në të cilin nuk ka patur asnjë pengesë për të punuar, është realizuar në masën 84%, ose 34,034,100 lekë, ose 6,635,800 lekë më pak se vlera totale e ofertuar për këtë nën objekt. Punimet në këtë nën objekt rezultojnë të kenë përfunduar në datën 10.04.2018 (situacioni nr. 4, datë 10.04.2018), ose 144 ((170 ditë (nga 21.10.2017- 10.04.2018) – 26 ditë të shtyra me amendamentin nr. 1, datë 16.03.2018) më vonë se afati kontraktual i përfundimit të punimeve. Në zbatim të nenit 17.4 të kontratës, sipas të cilit **“... Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve... për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës...”**, AK duhet të kishte kërkuar dëmet për vonesa në zbatim në formën e penaliteteve, në masën 3,822,221 lekë (6,635,800 * 4/1000 * 144

ditë, e cila është e ardhur e munguar për Bashkinë Shijak (trajtuar më hollësisht në faqet 121-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

B.II.10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikualifikimi i sheshit tek lagja Lugina”, Bashkia Shijak, me vlerë të kontratës 25,093,368 lekë me tvsh, fituar nga Operatori Ekonomik “Al-Asfalt” Shpk, rezultuan vonesa në përfundimin e punimeve, për të cilat duhej aplikuar penalteti në vlerën 3,680,366 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3411, datë 16.09.2016 të lidhur mes AK Bashkia Shijak dhe OE “Al-Asfalt” Shpk (trajtuar më hollësisht në faqet 50 - 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Në zbatim të nenit 17.4 të kontratës, sipas të cilit “... Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve... për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 e vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës...”, AK duhet të kishte kërkuar dëmet për vonesa në zbatim në formën e penalteteve, në masën 3,680,366 lekë ($16,728,940 * 4/1000 * 55$ ditë), e cila është e ardhur e munguar për Bashkinë Shijak (trajtuar më hollësisht në faqet 121-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

B.II.10. Rekomandim: Titullari i AK, në zbatim të kërkesave të nenit 77, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të marrë masa që për kontratat publike, të caktojë nëpunës për monitorimin e kontratës, i cili të pasqyrojë gjendjen faktike të realizimit të kontratës, cilësinë e punimeve dhe grafikut të punimeve, para certifikimit të punimeve të realizuara.

Menjëherë

B/III. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.

B.III.1.GJETJE NGA AUDITIMI. NGA AUDITIMI REZULTON SE NË BASHKINË SHIJAK, PËR VITET 2016, 2017, 2018 OBJEKTET E NDARA SIPAS KATEGORIVE TË CILAT JANË PAJISUR ME LEJE LEGALIZIMI PËR TË CILAT ËSHTË PËRLLOGARITUR TAKSA NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURE NGA DPTSHIP, JANË 990 OBJEKTE BANIMI, 93 OBJEKTE SOCIAL-EKONOMIKE DHE 98 OBJEKTE TË KOMBINUARA, NË SHKELJE TË KËRKESAVE TË LIGJIT NR. 9482 DATË 03.04.2016, “PËR LEGALIZIMIN, URBANIZIMIN DHE INTEGRIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE” I NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 50/2014 NENI 23, LIGJIT NR. 9632, DATË 30.10.2006, “PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE” TË NDRYSHUAR, VKM NR. 860, DATË 10.12.2014 “PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS SE MBLEDHJES DHE ADMINISTRIMIT TË TË ARDHURAVE PËR NDËRTIMET PA LEJE DHE VEPRAVE TË ZBATUESHME PËR LEGALIZIM”, I NDRYSHUAR DHE VKB NR.3, DATË 09.03.2016 “PAKETA FISKALE PËR VITIN 2016”, NR. 2, DATË 27.01.2017 “PAKETA FISKALE PËR VITIN 2017”, SIPAS ANEKSIT NR. 5/2 ME PASOJË TË

ARDHURA TË MUNGUARA PËR BUXHETIN E BASHKISË NË VLERËN 25,709,508 LEKË (TRAJTUAR MË HOLLËSISHT NË FAQET 40-48 TË RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT).

B.III.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Shijak të merrni masat për tu pasqyruar në kontabilitet, në pasqyrat financiare vjetore të vitit ushtrimor, të bashkëpunojë me ZVRPP Durrës për parandalimin e regjistrimit dhe njoftimin e qytetarëve dhe subjekte për pagesën në vlerën prej **25,709,508** lekë deri në likuidimin e plotë të kësaj vlere për taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë

C. MASA ADMINISTRATIVE:

PËR INSPEKTORATIN E MBROJTJES SË TERRITORIT VENDOR.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë, Kryetarit të Bashkisë Shijak t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative me gjobëpërnjë mbikëqyrës dhe një kolaudator punimesh**, si më poshtë:

1. **Z. Gëzim Islami, masën “gjobë”,** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në kontratën nr.3565 prot, datë 17.10.2017 me objekt “Rehabilitimi i hapësirave dhe rikonstruksioni i rrugëve tek lagjja e Kokomanëve, fshati Hardhishtë”, Bashkia Shijak, me sipërmarrës punimesh BOE “Senka” Shpk dhe “Egland” Shpk, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 997,990 lekësi rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.
2. **Z. Feti Deromema, masën “gjobë”,** në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në kontratën nr.3565 prot, datë 17.10.2017 me objekt “Rehabilitimi i hapësirave dhe rikonstruksioni i rrugëve tek lagjja e Kokomanëve, fshati Hardhishtë”, Bashkia Shijak, me sipërmarrës punimesh BOE “Senka” Shpk dhe “Egland” Shpk, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 997,990 lekësi rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, geramat (b, c, ç) e nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 shkronjën “k” të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për

vetëqeverisjen vendore”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Shijak që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, pranë Institucionit Tuaj marrjen e masës disiplinore, **për13 (trembëdhjetë) punonjës**, si më poshtë:

D.1 “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj ose pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 germa (b, c)- deri në Largim nga shërbimi civil”, neni 58 germa “ç”, për:

1. z. Ismail Gjergji, me detyrë Nënkyetar i Bashkisë **zj. Pranvera Alushi**, me detyrë Drejtore Ekonomike **zj. Jonida Goga**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit

Për shkeljet e kryera në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në 7 (shtatë) procedurat e mëposhtme:

“Rikualifikim i sheshit tek lagjia Lugina”, viti 2016

“Rikualifikim i kuartallës lagjia Kodër Shijak”, viti 2017

“Rikonstrukcion i rrjetit rrugor të qytetit Shijak”, viti 2017

“Rikonstrukcion i kanalit sekondar nga rezervuari Metallaj-Koxhas Fushë”, viti 2017

“Rehabilitim i sistemit ujitës Njësia Administrative Gjepalaj”, viti 2017

“Blerje automjeti dhe makineri për nevojat e bashkisë Shijak”, viti 2017

“Rindërtim i Shkollës 9-vjeçare Muharrem Dollaku”, viti 2017

KVO-ja ka mbajtur një qëndrim të qartë në lidhje me OE/BOE e tjerë, ku çdo mungesë në dokumentacion, sado e vogël, të konsiderohet mos përmbushje e kërkesave në DST, si edhe faktin që në nenin 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, gjykojmë se vendimet e marra nga KVO për shpalljen fitues të operatorëve ekonomikë edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (këtu e në vijim AK) dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (këtu e në vijim NJHDT), duke mos anuluar këto procedura, veprime këto me impakt negativ në buxhet për procedurat e prokurimit të shpallura dhe mos përputhje me dispozitat e ligjit të prokurimit publik dhe shpallur fitues me kriteret të paplota e konkretisht, janë në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa (c, ç, d, dh), nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, si dhe nenin 66, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

D.2 “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj ose pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 germa (b, c), për:

1. zj. Enkeleda Osmanaj, me detyrë Juriste e Prokurimeve **zj. Dorela Çurri**, me detyrë Përgjegjëse e Financës në Drejtorinë Financës **zj. Mirsida Shahini**, me detyrë Kryeinspektore e IMTV Bashkia Shijak

Për shkeljet e kryera në cilësinë e anëtarit të NJP, lidhur me kriteret e përcaktuara për procedurat e prokurimit të mëposhtme:

“Rikualifikim i Sheshit te lagjia Lugina”, viti 2016

“Ndërtim i Shkollës 9-Vjeçare fshati Shtrazë”, viti 2016

“Rehabilitim i hapësirave publike dhe rikonstruksion i rrugës tek lagjia e Kokomanëve, Ardhishtë”, viti 2017

“Rikualifikim i kuartallës lagjia Kodër Shijak”, viti 2017

“Rikonstruksion i rrjetit rrugor të qytetit Shijak”, viti 2017

“Rikonstruksion i kanalit sekondar nga rezervuari Metallaj-Koxhas Fushë”, viti 2017

“Rehabilitim i sistemit ujitës Njësia Administrative Gjepalaj”, viti 2017

“Rehabilitim i sistemit ujitës Njësia Administrative Maminas”, viti 2017

“Rindërtim i Shkollës 9-vjeçare Muharrem Dollaku”, viti 2017

Lidhur me kriteret e vendosura nga NJP ka rezultuar se ato edhe pse nuk kanë kufizuar në mënyrë të ndjeshme numrin e OE pjesëmarrës, në hartimin e kriterëve të kualifikimit, NJP nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së kriterëve, siç kërkohet shprehimisht nga neni 61 i VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, gjithashtu disa nga kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim me llojin e punës së kërkuar duke mos u argumentuar teknikisht dhe ligjërisht vendosja dhe miratimi i tyre (trajtuar më hollësisht në faqet 46-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

D.3 “Vërejtje” e parashikuar nga neni 58, shkronja (a), për:

1. z. Ruzhdi Shehi, me detyrë Specialist i Sektorit të PKZHT

Për shkeljet e kryera në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike, lidhur me kriteret e përcaktuara për procedurat e prokurimit të mëposhtme:

“Rehabilitim i hapësirave publike dhe rikonstruksion i rrugës tek lagjia e Kokomanëve, Ardhishtë”, viti 2017

“Rikualifikim i kuartallës lagjia Kodër Shijak”, viti 2017

“Rikonstruksion i kanalit sekondar nga rezervuari Metallaj-Koxhas Fushë”, viti 2017

“Rehabilitim i sistemit ujitës Njësia Administrative Gjepalaj”, viti 2017

“Rindërtim i Shkollës 9-vjeçare Muharrem Dollaku”, viti 2017

2. z. Fatmir Elezi, me detyrë Specialist Topograf

Për shkeljet e kryera në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike, lidhur me kriteret e përcaktuara për procedurat e prokurimit të mëposhtme:

“Rikonstruksion i kanalit sekondar nga rezervuari Metallaj-Koxhas Fushë”, viti 2017

“Rehabilitim i sistemit ujitës Njësia Administrative Gjepalaj”, viti 2017

3. z. Rustem Shahini, me detyrë Specialist Topograf. **zj. Lumturi Bici**, me detyrë Specialist Agronom

Për shkeljet e kryera në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike, lidhur me kriteret e përcaktuara për procedurat e prokurimit të mëposhtme:

“Rehabilitim i sistemit ujitës Njësia Administrative Maminas”, viti 2017

5. z. Bruno Tataveshi, me detyrë Specialist i Sektorit të PKZHT **6. z. Gjergj Çifligu**, me detyrë Specialist i Sektorit të Shërbimeve **z. Erind Vrahoriti**, me detyrë Specialist i Sektorit të PKZHT

Për shkeljet e kryera në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike, lidhur me kriteret e përcaktuara për procedurat e prokurimit të mëposhtme:

“Rindërtim i Shkollës 9-vjeçare Muharrem Dollaku”, viti 2017

Lidhur me kriteret e vendosura nga Komisioni i Vlerësimit të fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike, nga ku ka rezultuar se, nuk ka analiza të çmimit për njësi për zërat e parashikuar në manual, nuk është administruar apo hartuar dokument për mënyrën e përlllogaritjes së fondin limit, si dhe nuk kanë argumentuar përcaktimin e kriterëve për kualifikim, duke mos dokumentuar arsyet teknike e ligjore të vendosjes së kriterëve të cilat nuk janë në përpjesëtim me llojin e punës së kërkuar, siç kërkohet shprehimisht nga neni 61 i VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, (trajtuar më hollësisht në faqet 49-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

D/2. Për 2 (dy) punonjës që aktualisht rezultojnë në marrëdhënie pune me Bashkinë Shijak, të cilët edhe pse janë identifikuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për disa të meta e mangësi që nuk i kapërcejnë kufijtë e shkeljes administrative, për arsye se asnjëra prej tyre gjatë përmbushjes së detyrave, nuk ka ndikuar negativisht apo ka sjellë pasoja të konsiderueshme në mirëfunksionimin e institucionit, konsiderojmë që për to të mos propozohet masë, respektivisht:

1. **z. Avni Xhafa**, me detyrë Përgjegjës i MZSH-së
2. **z. Helidon Kalleshi**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve

D/3. Për 7 (shtatë) punonjës të cilët aktualisht nuk rezultojnë në marrëdhënie pune me Bashkinë Shijak, të cilët edhe pse janë identifikuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për të meta e mangësi në procedurat e prokurimit të zhvilluara gjatë vitit 2016, 2017 dhe 2018, konsiderojmë se nuk mund të propozohet masë, respektivisht:

1. **zj. Shpresa Domi**, me detyrë Ish-Nënkryetare e Bashkisë, në cilësinë e anëtarit të KVO
2. **zj. Sabina Hyka**, me detyrë ish-Specialiste e DPKZH, në cilësinë e anëtarit të NJP ose KLLFLST
3. **z. Qemal Vezi**, me detyrë ish-Ish-Ekspert i Jashtëm, në cilësinë e anëtarit të KLLFLST
4. **z. Migen Velaj**, me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Projekteve, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike
5. **z. Samet Habibi**, me detyrë ish-Specialist i Sektorit të PKZHT, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike
6. **zj. Esmeralda Zela**, me detyrë Specialiste e Sektorit të PKZHT, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike
7. **zj. Denada Berhamaj**, me detyrë Specialiste e Sektorit të Projekteve, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike

E. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecursë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

F. Kontratat e punimeve të lidhura midis Bashkisë Shijak dhe operatorëve ekonomik të shpallur fitues në procedurat e prokurimit, zbatimi i të cilave është në proces (si pasojë e zgjatjes së afateve të punimeve), do të jenë objekt në auditimin e radhës që do kryhet në Bashkinë Shijak.

Në rastin e fillimit të procedurave gjyqësore në funksion të zbatimit të këtij rekomandimit për "Masa për shpërblim dëmi", nga ana e Bashkisë Shijak, të kërkohet prezenca e KLSH-së, si palë e tretë në proces gjyqësor, duke informuar njëkohësisht KLSH-në, në lidhje me ecurinë dhe zhvillimet përgjatë procesit gjyqësor.

Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Vendimi përkatës i përcillen Kryetarit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak Shijak.

Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për masat e marra nga ana Juaj të përgatiten programe me afate dhe persona përgjegjës dhe për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit **brenda 20 ditëve** nga marrja e kësaj kërkesë.

DETYRIMET E PRAPAMBETURA PER VITIN 2018

Tabela nr. 2: Raporti përmbledhës për detyrimet e prapambetura per tremujorin Tetor-Dhjetor 2018

Kategoritë						TOTAL
Detyrimet e nj.v.q.v (lekë)	Investimet	TVSH dhe Kosto lokale	Mallra dhe Shërbime	Vendime Gjyqësore	Të tjera	
Vlera Totale	13,270,070		15,175,836	1,693,200		30,139,106

Shënim: Vlera totale në tab.2 duhet të jetë e barabartë me totalin e kolonës së fundit në tab 1. Pra, në këtë tabelë do të reflektohen detyrimet e mbetura të pashlyera sipas kategorive përkatëse

Tabela nr. 3: Raporti përmbledhës për detyrimet e prapambetura të **KRIJUARA RISHTAS** për tremujorin Tetor Dhjetor 2018

Kategoritë

Detyrimet e nj.v.q.v (lekë)	Investimet	TVSH dhe Kosto lokale	Mallra dhe Shërbime	Vendime Gjyqësore	Të tjera	TOTAL 28,445,906
Vlera Totale	13,270,070		15,175,836			

Tabela nr. 5: Raporti përmblledhës për detyrimet e mbetura nga **Investimet financuar nga FZHR për tremujorin Tetor -Dhjetor 2018**

	Emertimi i projektit	Ministria e Linjes	Viti I financimit te projektit	Vlera e plote e kontrates	Vlera e financuar ne vitin 2017	Vlera e financuar ne vitin 2018	Detyrimi i mbetur per financim
	Vlera totale			190,989,348	113,072,358	63,361,511	14,555,479
	Ndertimi i Shkolles 9-vjecare Rreth	FZHR	2014, 2015	72,000,000	71,473,753	-	526,247
	Sistem asfalt Rruga 8-Marsi Shijak	FZHR	2,014	19,621,872	11,598,605	-	8,023,267
	Rikons I Rrjetit Rrugor Shijak	FZHR	2,017	99,367,476	30,000,000	63,361,511	6,005,965

Pasqyra Financiare e vitit 2018

NJESIA PUBLIKE	NJQP_01	Formati nr.1
BASHKIA SHIJAK	PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	VITI 2018

NE / LEKE

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	EMERTIMI	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	A	AKTIVET	2,670,494,227	2,744,964,366
2		I.Aktivët Afat shkurtra	260,880,646	358,262,642
3		1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	90,783,761	203,218,941
4	531	Mjete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjete monetare ne Banke		
6	520	Disponibilitete ne Thesar	87,546,516	198,620,296
7	50	Letra me vlere		
8	532	Vlera te tjera	3,237,245	4,598,645
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		

10	59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)		
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	61,537,438	59,181,955
12	31	Materiale	8,301,027	9,304,170
13	32	Inventar l imet	53,236,411	49,877,785
14	33	Prodhim nre proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe ne rritje e majmeri		
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)		
21		3.Llogari te Arketushme	99,878,591	95,861,746
22	411	Kliente e llogari te ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba		
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbuloohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqerore		
28	436	Sigurime Shendetsove		
29	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
30	44	Institucione te tjera publike		
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitore te ndryshem	85,959,524	82,141,666
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	13,919,067	13,720,080
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	8,680,856	0
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	8,680,856	
42		II.Aktivt Afat gjata	2,409,613,581	2,386,701,724
43	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	60,175,348	14,409,516
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime	60,175,348	14,409,516
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47	21	2.Aktive Afatgjata materiale	2,330,490,206	2,310,924,341
48	210	Toka, T,roje, Terene	24,685,005	23,835,005
49	211	Pyje, Plantacione	4,830,000	4,830,000
50	212	Ndertesa e Konstruksione	526,244,385	559,861,929

51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	1,702,594,779	1,616,763,562
52	214	linstalime teknike, makineri e paisje	19,876,816	37,732,122
53	215	Mjete Transporti	30,977,896	41,120,188
54	216	Rezerva Shteterore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	21,281,325	26,781,535
57	24	Aktive afatgjata te demtuara		
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	0	0
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
62		4.Investime	18,948,027	61,367,867
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		42,419,840
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale	18,948,027	18,948,027
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	131,408,031	115,790,006
66		I.Pasivet Afat shkurtra	131,408,031	115,790,006
67		1. Llogari te Pagushme	131,408,031	115,790,006
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	5,178,800	11,775,498
69	42	Detyrime ndaj personelit	9,957,000	9,612,230
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	622,809	869,198
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	3,339,258	3,238,652
76	436	Sigurime Shendetsores		
77	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	17,255,856	15,329,615
82	467	Kreditore te ndryshem	12,180,101	4,898,645
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime	82,874,207	70,066,168
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		2.Te tjera pasive afatshkurtra	0	0
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
91		II.Pasivet Afat Gjata	0	0

92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provigjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	2,539,086,196	2,629,174,360
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	2,539,086,196	2,629,174,360
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,872,646,389	1,941,236,320
99	12	Rezultatet e mbartura	0	0
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	70,290,660	183,290,681
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime		
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme	596,149,147	504,647,359
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
105	107	Vlera e mjewteve te caktuara ne perdorim		
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata		
107		Te Tjera		
108	E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	2,670,494,227	2,744,964,366
KONTROLLE				
		Shifra 0(Zero)- Tregon Kuadraturen	Kuadratura	Kuadratura
	Kontroll 1.	Aktivet Neto a jane te barabarta me Fondin e Konsoliduar	0	0
	Kontroll 2.	Totali I Aktiveve a eshte i barabarte me = Totalin e Pasiveve	0	0

Sic shihet nga bilaci Bashkia Shijak per vitin 2018 rezulton me 70.290.660 leke gjendje ne llogarine e thesari si celje per vitin 2019.Kjo shume detajohet me VKB mbledhjen per shtese Buxheti per vitin 2019.

Drejtori Ekonomik

Pranvera Alushi